

RREGULLORE

E DHOMËS KOMBËTARE
TË ZGJIDHJES SË
MOSMARRËVESHJEVE

BOTIM ZYRTAR 2024



**FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT**

FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

President:	Armand DUKA
Sekretar i Përgjithshëm:	Illir SHULKU
Themeluar:	1930
Anëtare e UEFA-s:	1954
Anëtare e FIFA-s:	1930

Realizoi botimin:

Botime “Reklama”

TRYEZA E LËNDËS

TITULLI I	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	2
Kreu 1	Kompetencat	3
Neni 1	Objekti	
Kreu 2	Përbërja dhe organizimi	4
Neni 2	Përbërja e DHKZM	5
Neni 3	Organizimi dhe përbërja e DHKZM	6
Neni 4	Sekretaria e DHKZM	7
TITULLI II	RREGULLAT BAZË PROCEDURALE	6
Kreu 1	Parashikime të përgjithshme	7
Neni 5	Qëllimi i zbatimit: rregullat themelore	8
Neni 6	Selia	0
Neni 7	Gjuha	6
Neni 8	Përfaqësimi	8
Neni 9	Njoftimet dhe komunikimet	7
Neni 10	Afatet kohore	9
Neni 11	Pavarësia e anëtarëve të trupave gjkuese të DHKZM	5 4
Neni 12	Kërkesa për përjashtim	6
Neni 13	Dorëheqja	7
Neni 14	Masat e përkohshme	8
TITULLI III	DISPOZITA TË POSAÇME PËR PROCEDURËN PËRPARA DHOMËS SË ARBITRAZHIT	6
Kreu 1	Arbitrazhi	0
Neni 15	Kërkesa për Arbitrazh	7
Neni 16	Prapësimet/Deklarata e të Paditurit/Kundërpadia	6



TITULLI IV		FORMIMI	
		I GJYKATËS SË ARBITRAZHIT	7
Kreu 1	Gjykata e arbitrazhit		8
	Neni 17	Numri i arbitrave	8
	Neni 18	Emërimi i arbitrave	8
Kreu 2	Pjesëmarrja e personave të tretë në arbitrazh		7
	Neni 19	Pjesëmarrja e personave të tretë në proces	7
	Neni 20	Pajtimi	7
	Neni 21	Konfidencialiteti	5
TITULLI V		RREGULLAT PROCEDURALE TË GJYKIMIT PARA DHKZM	6
Kreu 1	Procedurat përpara trupit gjykues		6
	Neni 22	Forma e procedimit	5
	Neni 23	Seanca dëgjimore	5
	Neni 24	Marrja e provës tek të tretët	6
	Neni 25	Procedura e përshpejtuar	7
Kreu 2	Gjykimi në themel		7
	Neni 26	Ligji i zbatueshëm për themelin	6
	Neni 27	Vendimi	5
Kreu 3	E drejta e ankimit		8
	Neni 28	Apelimi	9
	Neni 29	Përfundimi nga përgjegjësia	9
	Neni 30	Hyrja në fuqi	9
ANEKSI nr.1:	TARIFAT E SHERBIMEVE TË DHKZM		7





DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

TITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU 1 **Kompetencat**

Neni 1 **Objekti**

- 1.1 Dhoma Kombëtare e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve këtu e në vijim (DHKZM), ka juridiksion për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lidhen në çdo mënyrë me sportin e futbollit, me karakter civil/tregtar dhe që lindin nga marrëdhëniet juridike civile të subjekteve që i nënshtrohen juridiksionit të FSHF dhe/ose që marrin pjesë në veprimtaritë e FSHF dhe /ose subjekteve që zgjedhin t'i drejtohen DHKZM në lidhje me këto mosmarrëveshje me anë të arbitrazhit dhe/ose ndërmjetësimit, në përputhje me Rregullat Procedurale.
- 1.2 Për këtë qëllim, DHKZM siguron infrastrukturën e nevojshme, administron listat e anëtarëve të trupave gjyquese, emëron Trupat Gjyquese dhe mbikëqyr zhvillimin e efektshëm të procedurave.
- 1.3 Nën juridiksionin e DHKZM veprojnë Trupat Gjyquese që kanë kompetencat e mëposhtme:
 - a. Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me qëndrueshmërinë kontraktuale të lojtarëve dhe trajnerëve të futbollit me subjektet anëtare të FSHF-së ose që marrin pjesë në aktivitetet e organizuara prej saj që i referohen DHKZM përmes arbitrazhit të zakonshëm;
 - b. Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lidhen me përcaktimin/ konstatimin e statusit të lojtarit sipas “Rregullores për Statusin dhe Transferimin e Lojtarëve” të FSHF-së;



- c. Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lidhen me kompensimin për periudhën e formimit (kompensimin për trajnim) dhe me pasaportën e lojtarit;
 - d. Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet klubeve dhe të gjithë stafit të kërkuar për përmbushjen e kriteve të licensimit.
 - e. Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që i drejtohen DHKZM nga subjekte të treta ose që përfshijnë subjekte të treta që janë në marrëdhënie civile tregtare me subjekte që i nënshtrohen juridiksionit të FSHF-së dhe/ose që marrin pjesë në veprimtaritë e FSHF-së.
- 1.4 Trupat gjyquese të DHKZM do të gjykojnë me një ose tre anëtarë. 1.5 Trupa Gjyquese përbëhet nga një anëtar i vetëm në rastet e mëposhtme:
- a. Kur gjykohen mosmarrëveshje, me vlerë të përgjithshme deri në 1.000.000 lekë.
 - b. Kur palët bien dakord.
 - c. Kur gjykohen mosmarrëveshje që lidhen me Statusin e Lojtarit, sipas Neneve 14, 14/a, 15 të Rregullores së Statusit të Lojtarit.

KREU 2 Përbërja dhe organizimi

Neni 2 Përbërja e DHKZM

- 2.1 Kryetari, nënkryetarët dhe anëtarët e DHKZM emërohen sipas statutit të FSHF-së me mandat 4-vjeçar me të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat tjetër. Procedura për formimin e trupave gjyqesues përcaktohet sipas kësaj rregulloreje.
- 2.2 FSHF publikon listën anëtarëve të DHKZM, si dhe të gjitha ndryshimet e mundshme në të.



- 2.3 Nëse një anëtar i DHKZM jep dorëheqjen, vdes ose nuk është në gjendje të kryejë funksionet e tij/saj për ndonjë arsye tjetër, ai/ ajo do të zëvendësohet për periudhën e mbetur të mandatit të tij/saj, në përputhje me kushtet e zbatueshme për emërimin e tij/saj.
- 2.4 Pas emërimit të tyre, anëtarët e DHKZM nënshkruajnë një deklaratë zyrtare ku marrin përsipër të ushtrojnë funksionet e tyre personalisht me objektivitet, pavarësi dhe paanshmëri të plotë, dhe në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje. Detyrimi për të qenë i paanshëm dhe i pavarur në ushtrimin e funksioneve sipas kësaj rregulloreje, është një detyrim me karakter vazhdues.
- 2.5 Anëtarët e trupave gjykuese të DHKZM nuk mund të veprojnë si këshilltar/avokat për një palë përpara DHKZM.
- 2.6 Anëtarët e trupave gjykuese të DHKZM kanë detyrimin e konfidencialitetit, i cili parashikohet në Rregullore, dhe në veçanti nuk duhet t'i zbulojnë apo t'i bëjnë publike ndonjë palë të tretë fakte ose informacione të tjera në lidhje me procedurat e kryera para DHKZM.
- 2.7 Komiteti Ekzekutiv ka të drejtën të shkarkojë një anëtar nga lista e trupave gjykuese të DHKZM, përkohësisht ose për-gjithmonë, nëse ai/ajo shkel ndonjë rregull të kësaj Rregulloreje ose nëse veprimi i tij/saj cenon emrin e mirë të DHKZM-së dhe/ose FSHF-së.

Neni 3 Organizimi dhe Përbërja e DHKZM

- 3.1 DHKZM është e përbërë nga dy dhoma, Dhoma e Arbitrazhit, dhe Dhoma e Statusit të Lojtarit.
- a. Dhoma e Arbitrazhit përbëhet nga trupa gjykuese të përbërë nga 1 (një) anëtar ose 3 (tre) që kanë për objekt gjykimin e mosmarrëveshjeve të parashikuara nga Neni 1.3, pika a, c, d, f dhe g e kësaj Rregulloreje.



- b. Dhoma e Statusit të Lojtarit përbëhet nga trupa gjyquese me 1(një) anëtar në rastet e parashikuara nga neni 1.5, pika c, e kësaj Rregulloreje dhe me 3(tre) anëtarë në rastet e tjera.
- 3.2 Palët në një procedurë gjykimi kanë të drejtë të kërkojnë që anëtarët e trupës gjyquese të secilës dhomë të përjashtohen nga shqyrtimi i një çështjeje të caktuar nëse ekzistojnë rrethana që shkaktojnë dyshime të arsyeshme dhe të bazuara në lidhje me paanësinë dhe pavarësinë e tyre në raport me palët.
- 3.3 Anëtarët e trupave gjyquese kanë të drejtën të dorë hiqen paraprakisht, nëse, në procedurën e arbitrazhit ku janë emëruar,
- a. kanë interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, personalisht apo si përfaqësues të një pale;
 - b. kanë lidhje gjinie ose krushqie të afërt me palët në gjykim;
 - c. kanë marrëdhënie varësie, miqësie apo konflikte personale me një palë;
 - d. janë ose kanë qenë kreditor/debitor, përfaqësues ligjor të një pale.
 - e. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkretë, arsye serioze njëanshmërie.
- 3.4 Kryetari i DHKZM vendos mbi rastet dhe procedurat e përjashtimit.
- 3.5 Nëse vetë kryetari i DHKZM kërkohet të përjashtohet, funksionet që lidhen me rastet dhe procedurat e përjashtimit, do të kryhen nga zëvendësi i tij.



Neni 4 Sekretaria e DHKZM

- 4.1 Sekretaria e DHKZM merr përsipër të gjitha veprimet e duhura administrative për të siguruar vijueshmërinë normale të procedurave të arbitrazhit. Ajo i komunikon aktet e procedurave palëve së bashku me njoftimet e tjera sipas rastit.
- 4.2 Sekretaria e DHKZM merr pjesë në të gjitha veprimet për të cilat duhet të mbahet procesverbal.
- 4.3 Sekretaria e DHKZM regjistron çështjet, formon fashikujt gjyqësorë, duke futur atje dokumente ose kopje të tyre dhe shënon menjëherë datën e depozitimit, i ruan ato, përpilon komunikimet dhe njoftimet e parashikuara nga kjo Rregullore ose nga trupi gjykues dhe detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor.





**RREGULLAT
BAZË
PROCEDURALE**

TITULLI II RREGULLAT BAZË PROCEDURALE

KREU 1 Parashikime të përgjithshme

Neni 5 Qëllimi i zbatimit: rregullat themelore

Këto rregulla procedurale zbatohen për çdo mosmarrëveshje që i referohet DHKZM sipas parashikimeve të Nenit 1.3 të kësaj Rregulloreje.

Neni 6 Selia

Selia e DHKZM dhe e çdo trupe gjyquese që vepron nën jurisdikcionin e saj është në Tiranë, pranë selisë së FSHF.

Neni 7 Gjuha

- 7.1 Gjuhët e punës të DHKZM janë; Shqipja dhe Anglishtja.
- 7.2 Në mungesë të marrëveshjes midis palëve, kryesuesi i trupës gjyquese ose arbitri i vetëm, zgjedh njërin nga këto dy gjuhë si gjuhë arbitrazhi në fillim të procedurës, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat përkatëse. Pas kësaj, procedurat do të zhvillohen ekskluzivisht në atë gjuhë, përveç nëse palët dhe trupi gjyques bien dakord ndryshe.
- 7.3 Trupi Gjyques gjatë seancës, lejon një palë të përdorë një gjuhë tjetër nga ajo e zgjedhur për arbitrazhin, me kushtin që ajo të sigurojë, me kostot e veta, përkthimin me gojë dhe me shkrim për dokumentet e nevojshme në dhe nga gjuha zyrtare e arbitrazhit.



Neni 8 Përfaqësimi

- 8.1 Palët mund të përfaqësohen nga personat e zgjedhur prej tyre. Emrat, adresat, adresat e postës elektronike, numri i telefonit të personave që përfaqësojnë palët do t'i komunikohen sekretariatit të DHKZM, palës tjetër dhe trupit gjykues.
- 8.2 Përveç kur deklarohet në seancë nga pala, çdo përfaqësues duhet të jetë i pajisur me akt përfaqësimi lëshuar nga vetë pala apo përfaqësuesi ligjor i saj.
- 8.3 Anëtarët e DHKZM, anëtarët e Komitetit Ekzekutiv dhe anëtarët e sekretariatit të përgjithshëm të FSHF, nuk mund të jenë përfaqësues të palëve në proces.

Neni 9 Njoftimet dhe komunikimet

- 9.1 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet që DHKZM ose trupi gjykues kryejnë me palët do të bëhen përmes sekretariatit të DHKZM.
- 9.2 Njoftimet dhe komunikimet dërgohen në adresën elektronike nëno përcaktuar në kërkesën për arbitrazh, ose në ndonjë adresë tjetër të specifikuar në një datë të mëvonshme.
- 9.3 Të gjitha njoftimet procedurale dhe vendimet e tjera të marra nga DHKZM do të njoftohen me anë të postës elektronike, në mungesë të saj, njoftimi do të kryhet përmes një forme që lejon provën e marrjes.
- 9.4 Në çdo rast, kërkesa origjinale për arbitrazh (kërkesë padia) dhe aktet që i bashkëngjiten, duhet të dorëzohen në sekretarinë e DHKZM nga palët në të paktën tre kopje.
- 9.5 Nëse ato dërgohen paraprakisht me faksimile ose me postë elektronike në adresën zyrtare të e-mailit DHKZM (dhkzm@fshf.al), regjistrimi është i vlefshëm pas marrjes së postës elektronike nga sekretaria e DHKZM.



- 9.6 Shtojcat e bashkëngjitura në çdo korrespondencë me shkrim mund të dërgohen në sekretarinë e DHKZM me postë elektronike, me kusht që ato të jenë të listuara dhe secila shtojcë të identifikohet qartë.

Neni 10 Afatet kohore

- 10.1 Afatet e përcaktuara në bazë të kësaj Rregulloreje fillojnë të llogariten nga e nesërmja e marrjes së njoftimit ose komunikimit nga pala.
- 10.2 Festat zyrtare dhe ditët e pushimit përfshihen në llogaritjen e afateve kohore. Afatet kohore të përcaktuara sipas kësaj Rregulloreje, konsiderohen të respektuara nëse komunikimet nga palët dërgohen para mesnatës, në ditën e fundit në të cilën mbaron afati kohor.
- 10.3 Nëse dita e fundit e afatit kohor është një festë zyrtare ose një ditë pushimi zyrtar në Republikën e Shqipërisë, afati përfundon në fund të ditës së parë pasuese të punës.
- 10.4 Përjashtimisht dhe vetëm për shkaqe të arsyeshme, pas konsultimit me palët, kryesuesi i trupit gjykues ose, nëse ai ende nuk është emëruar, kryetari i DHKZM, mund të zgjasë afatet e parashikuara në këtë Rregullore, nëse rrethanat e lejojnë dhe me kusht që afati që kërkohet të zgjatet të mos ketë përfunduar.

Neni 11 Pavarësia e anëtarëve të trupave gjykuese të DHKZM

Çdo anëtar i trupës gjyqësore të DHKZM duhet të jetë dhe duhet të mbetet i paanshëm e i pavarur nga palët dhe do të deklarojë menjëherë çdo rrethanë që i jep shkas çdo dyshimi të arsyeshëm në lidhje me pavarësinë apo paanshmërinë tij/saj ndaj cilësdo nga palët.



Neni 12 Kërkesa për përjashtim

- 12.1** Palët mund të kërkojnë përjashtimin e një arbitri nëse rrethanat krijojnë dyshime të arsyeshme mbi pavarësinë e tij/saj ose mbi paanshmërinë e tij/saj, sipas kriterëve të vendosura në nenin 3 të kësaj Rregulloreje. Kërkesa duhet të paraqitet brenda 3(tre) ditëve nga njohja e emrit të arbitrit ose zbulimit të shkakut të përjashtimit.
- 12.2** Kërkesa për përjashtim duhet të paraqitet nga pala që e ngre atë, në formë shkresore drejtuar sekretariatit të DHKZM dhe duhet të përmbajë shkaqet e përjashtimit, dokumentet e provat e tjera që mbështesin kërkesën.
- 12.3** Kërkesat për përjashtim gjykohen nga kryetari i DHKZM. Ndaj vendimit për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për përjashtim lejohet ankim vetëm për efekt të kundërshtimit të vendimit përfundimtar sipas kufizimeve të vendosura në Kodin e Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë apo në ligje të tjera, në lidhje me kriteret për caktimin e Gjykatës së Arbitrazhit.

Neni 13 Dorëheqja

Anëtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, i kërkon kryetarit të DHKZM zëvendësimin e tij. Kryetari i DHKZM, kur e sheh me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një anëtar tjetër.

Neni 14 Masat e përkohshme

- 14.1** Me kërkesën e njëres palë, DHKZM, brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës, lejon marrjen e masave të përkohshme, kur ajo e konsideron të nevojshme ose të arsyeshme për të garantuar interesat që janë në gjykim.



14.2 Kërkesa për masa të përkohshme mund të bëhet në çdo fazë të gjykimit, derisa nuk është shpallur ende vendimi përfundimtar.

14.3 Kërkesa mund të shqyrtohet në seancë dëgjimore ose mbi bazë dokumentare sipas vlerësimit të trupës gjyquese.

Vendimi për masën është i ekzekutueshëm menjëherë,
14.4 sipas rregullave për ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit.

Në çdo kohë trupi gjyques me kërkesë të palëve, kur provohet se kanë ndryshuar rrethanat në të cilat u dha masa,
14.5 mund të vendosë ndryshimin ose revokimin e masës. Vendimi për ndryshimin ose revokimin e masës është i ekzekutueshëm menjëherë, sipas rregullave për ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit.





**DISPOZITA
TË POSAÇME
PËR PROCEDURËN
PËRPARA DHOMËS
SË ARBITRAZHIT**

TITULLI III

DISPOZITA TË POSAÇME PËR PROCEDURËN PËRPARA DHOMËS SË ARBITRAZHIT

KREU 1 Arbitrazi

Neni 15 Kërkesa për Arbitrazh

- 15.1 Pala që synon të paraqesë një çështje në arbitrazh sipas kësaj Rregulloreje (paditësi) do të paraqesë një kërkesë në sekretariatën e DHKZM e cila përmban:
- a. emrin dhe adresën e plotë të palëve dhe përfaqësuesve të tyre;
 - b. një deklaratë të shkurtër të fakteve dhe argumentimit ligjor, përfshirë një deklaratë të çështjes që duhet t'i paraqitet DHKZM për përcaktim;
 - c. kërkesën e tij për masa të përkohshme (nëse ka);
 - d. një kopje të kontratës që përmban marrëveshjen e arbitrazhit ose referim në dokumentin nga e cila rrjedh marrëveshja e arbitrazhit;
 - e. të gjithë dokumentet që kërkohen të merren në konsideratë nga trupi gjykues si prova;
 - f. çdo informacion të rëndësishëm në lidhje me numrin dhe zgjedhjen e arbitrit (arbitrave); nëse marrëveshja përkatëse e arbitrazhit parashikon tre arbitra, emrin e arbitrit nga lista DHKZM e arbitrave të zgjedhur nga paditësi.
- 15.2 Pas paraqitjes së kërkesës së tij, paditësi paguan tarifën gjyqësore të parashikuar në Aneksin Nr.1 që i bashkëlidhet kësaj Rregulloreje.



- 15.3 Nëse kërkesat e lartpërmendura nuk përmbushen kur paraqitet kërkesa për arbitrazh, sekretaria e DHKZM mund t'i japë vetëm njëherë një afat maksimal prej 5 (pesë) ditë paditësit për të plotësuar të metat, në rast të kundërt çështja do të konsiderohet se nuk është paraqitur, pa cenuar të drejtën e palës për paraqitjen e Kërkesës për Arbitrazh në një moment tjetër
- 15.4 Procedura e arbitrazhit konsiderohet e filluar me paraqitjen, sipas kushteve të këtij Neni, të kërkesës për Arbitrazh.

Neni 16 Prapësimet/Deklarata e të Paditurit/Kundërpadia

- 16.1 I padituri mund të kërkojë që afati i paraqitjes së prapësimëve dhe/ose kundërpadisë të përcaktohet pas pagesës nga paditësi i pjesës së tij në parapagimin e kostove.
- 16.2 Trupi gjykues vendos edhe kryesisht mbi juridiksionin e tij, përveç nëse arsyet thelbësore diktojnë pezullimin e procedurës. Kundërshtimi për juridiksionin paraqitet vetëm pasi është krijuar trupa gjykuese.
- 16.3 Kur ngrihet një kundërshtim për juridiksionin DHKZM, trupi gjykues fton palët të paraqesin parashtrësa me shkrim mbi juridiksionin. Trupi gjykues vendos mbi juridiksionin në çdo fazë të gjykimit.
- 16.4 Për paraqitjen dhe pranimin për shqyrtim të kundërpadisë zbatohen për aq sa është e mundur rregullat e parashikuara në Nenin 15/1 dhe 15/3.







**FORMIMI
I GJYKATËS
SË ARBITRAZHIT**

TITULLI IV FORMIMI I GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

KREU 1 Gjykata e Arbitrazhit

Neni 17 Numri i arbitrave

Gjykata e Arbitrazhit përbëhet nga një ose tre arbitra. Nëse palët, në marrëveshjen/kontratën objekt gjykimi, nuk kanë përcaktuar ndryshe, kryetari i DHKZM përcakton numrin, duke marrë parasysh rrethanat, kompleksitetin dhe vlerën në mosmarrëveshje.

Neni 18 Emërimi i arbitrave

- 18.1 Palët mund të bien dakord për mënyrën e emërimit të anëtarëve të trupave gjykuese nga lista DHKZM. Në mungesë të marrëveshjes, arbitrat do të emërohen në përputhje me paragrafët e mëposhtëm.
- 18.2 DHKZM do të mblidhet, si rregull, me një trupë gjykuese prej tre anëtarësh. Secila nga palët ka të drejtë të zgjedhë një anëtar të trupës gjykuese nga lista e DHKZM. Anëtarët e zgjedhur nga palët, brenda 10 ditësh kanë të drejtë të zgjedhin edhe anëtarin e tretë që është njëherazi kryesuesi i trupës gjykuese.
- 18.3 Në rast se pala e paditur nuk përzgjedh anëtarin e saj të trupit gjykues, atëherë brenda afatit të treguar më lart sipas nenit 17, atëherë anëtari i trupës dhe kryesuesi zgjidhen me short nga kryetari i DHKZM-së.
- 18.4 Në rast se anëtarët e zgjedhur nga palët nuk arrijnë të zgjedhin kryesuesin brenda afatit të treguar më lart, kryetari i DHKZM-së e zgjedh atë me short.



- 18.5 Në rastet kur, sipas kësaj rregulloreje, trupa gjyquese përbëhet nga një anëtar i vetëm, palët kanë të drejtë ta zgjedhin atë me marrëveshje nga lista e DHKZM-se brenda 10 ditësh nga dita kur i njoftohet të paditurit kërkesa për arbitrazh.
- 18.6 Në rast se palët nuk arrijnë të zgjedhin anëtarin e vetëm të trupës gjyquese brenda afatit të treguar më lart, kryetari i DHKZM-së e zgjedh atë me short.

KREU 2 Pjesëmarrja e personave të tretë në arbitrazh

Neni 19 Pjesëmarrja e personave të tretë në proces

- 19.1 Çdo palë që pretendon kundër ndonjë pale tjetër një të drejtë të ndryshme nga objekti i kërkesës për arbitrazh ose i kundërpadisë, ose deklaratës së mbrojtjes, ose pala që ka një pretendim kundrejt një personi të tretë, ose një person i tretë që pretendon një të drejtë kundër një pale ekzistuese, paraqet një kërkesë në përputhje me kushtet e nenit 15.1 dhe 17.2, për aq sa është e zbatueshme
- 19.2 Sekretaria e DHKZM do t'i komunikojë palëve një kopje të kësaj kërkesë dhe do të përcaktojë një afat 10 ditor që ato të shprehin qëndrimin e tyre për pjesëmarrjen e palës së tretë dhe të paraqesë në masën e zbatueshme, një qëndrim lidhur me ndërhyrjen.
- 19.3 Kërkesa sipas këtij neni mund të paraqitet derisa nuk është formuar trupi gjyqës.
- 19.4 Vendimi për pranueshmerinë e kërkesës së personit të tretë sipas nenit 19.1 do të merret pas formimit të trupës gjyquese.
- 19.5 Një palë e tretë e ndryshme nga ato të treguara në nenin 1 të kësaj rregulloreje mund të marrë pjesë në arbitrazh



vetëm nëse është e lidhur me marrëveshjen e arbitrazhit ose nëse ajo pranon me shkrim juridiksionin e DHKZM-së

Neni 20 Pajtimi

- 20.1 Është detyrë e gjykatës së arbitrazhit që të bëjë përpjekje për të pajtuar palët në mosmarrëveshje.
- 20.2 Në çdo fazë të gjykimit, me pëlqimin e palëve, zgjidhja e mosmarrëveshjes me mirëkuptim mund të përfshihet në një vendim të gjykatës së arbitrazhit.

Neni 21 Konfidencialiteti

- 21.1 Procedurat që zhvillohen sipas kësaj Rregulloreje janë konfidenciale. Palët, anëtarët e gjykatës së arbitrazhit dhe sekretaria e DHKZM marrin përsipër të mos zbulojnë para palëve të treta asnjë fakt ose informacion tjetër në lidhje me mosmarrëveshjen ose procedurat.
- 21.2 Përveçse kur të gjitha palët bien dakord, vendimet nuk do të bëhen publike.





**RREGULLAT
PROCEDURALE
TË GJYKIMIT
PARA DHKZM**

PROCEDURAT PËRPARA DHOMËS SË STATUSIT TË LOJTARIT

Dispozitat e posaçme të Titullit III dhe IV zbatohen për aq sa është e mundur për kërkesat e paraqitura para Dhomës së Statusit të Lojtarit.

TITULLI V RREGULLAT PROCEDURALE TË GJYKIMIT PARA DHKZM

KREU 1 Procedurat përpara trupit gjykues

Neni 22 Forma e procedimit

- 22.1 Gjykimi përpara trupit gjykues konsiston, në parim, në parashtresat me shkrim dhe seancën dëgjimore.
- 22.2 Pas marrjes së çështjes, nëse është e nevojshme, trupa gjykuese nxjerr udhëzime në lidhje me parashtresat me shkrim.
- 22.3 Si rregull i përgjithshëm, do të ketë një parashtresë (paditësi), një prapësim (i padituri) dhe, nëse rrethanat e kërkojnë, një kundërpërgjigje dhe një përgjigje e dytë.
- 22.4 Palët, në parashtrimet me shkrim, mund të ngrenë pretendime që nuk përmbahen në kërkesën për arbitrazh dhe në prapësimet.



- 22.5** Së bashku me parashtrësat e tyre me shkrim, palët duhet të paraqesin të gjitha provat ku do të mbështeten pretenzimet e tyre. Pas shkëmbimit të parashtrësave me shkrim, palët nuk mund të paraqesin prova të tjera, përveçse me marrëveshje të ndërsjellë, ose nëse trupi gjykues e lejon, në bazë të rrethave të jashtëzakonshme.
- 22.6** Në kërkesën për arbitrazh (padinë), kërkesat në lidhje me statusin e lojtarit ose parashtrësat e tyre me shkrim, palët do të shënojnë emrin e çdo dëshmitari, të cilin ata duan të thërrasin, duke përfshirë një përmbledhje të shkurtër të dëshmisë së tyre të pritshme, dhe emrin e çdo eksperti, duke deklaruar fushën e tyre të ekspertizës. Çdo deklaratë e dëshmitarëve do të depozitohet së bashku me parashtrësat e palëve, përveç nëse trupa gjykuese vendos ndryshe.
- 22.7** Nëse është ngritur një kundërpadi dhe/ose një kundërshtim juridiksional, sekretaria e DHKZM cakton një afat deri në 5 (pesë) ditë që paditësi të paraqesë përgjigje për kundërpadinë dhe/ose kundërshtimin juridiksional.

Dëshmitarët /Ekspertët

Rregullat Procedurale të përfutimit të dëshmisë dhe raporteve të ekspertëve

Neni 23 Seanca dëgjimore

- 23.1** Pas konsultimit me palët, trupi gjykues, nëse vlerëson se shpjegimet dhe dokumentet e palëve janë të qarta, vendos të procedojë mbi bazë dokumentesh, pa zhvilluar seancë me pjesëmarrjen e palëve.
- 23.2** Si rregull gjykimet e mosmarrëveshjeve që bëhen nga trupa gjykuese e përbërë me një anëtar për vlerat deri



në 1.000.000 lekë do të zhvillohen mbi bazë dokumentesh, përveçse kur trupa gjykuese vendos ndryshe.

23.3

Nëse do të mbahet seanca dëgjimore, trupa gjykuese nxjerr udhëzime në lidhje me seancën sa më shpejt të jetë e mundur dhe cakton datën e seancës dëgjimore. Si rregull i përgjithshëm, do të ketë një seancë gjatë së cilës trupi gjykues dëgjon palët, çdo dëshmitar dhe çdo ekspert, si dhe argumentet verbale përfundimtare të palëve, për të cilat i padituri dëgjohej i fundit.

23.4 Kryesuesi i trupit gjykues do të drejtojë seancën duke siguruar që deklaratat e bëra të jenë koncize dhe të fokusuara tek objekti i mosmarrëveshjes.

23.5 Me përjashtim kur të gjitha palët bien dakord ndryshe, seancat dëgjimore nuk janë publike.

23.6 Seanca dëgjimore mund të regjistrohet. Çdo person i dëgjuar nga trupi gjykues mund të asistohet nga një përkthyes me koston e palës që e ka thirrur atë person.

23.7 Palët mund të thërrasin vetëm dëshmitarë dhe ekspertë të cilët janë kërkuar në parashtresat apo prapësimet e tyre me shkrim. Secila palë është përgjegjëse për disponueshmërinë dhe kostot e dëshmitarëve dhe ekspertëve që ajo ka thirrur.

23.8 Kryesuesi i trupit gjykues mund të vendosë që të zhvillojë një seancë dëgjimore përmes video-konferencës ose të dëgjojë disa palë, dëshmitarë dhe ekspertë përmes telekonferencës ose video-konferencës. Me marrëveshjen e palëve, ai/ajo mund të përjashtojë një dëshmitar ose ekspert nga paraqitja në seancë nëse dëshmitari ose eksperti më parë ka paraqitur një deklaratë ose raport me shkrim.



- 23.9 Trupi gjykues mund të kufizojë ose të mos lejojë paraqitjen e ndonjë dëshmitari ose eksperti, ose ndonjë pjese të dëshmisë së tyre, për shkak se nuk përbën interes për çështjen.
- 23.10 Para se të dëgjojë ndonjë dëshmitar, ekspert ose përkthyes, trupi gjykues do ta ftojë në mënyrë solemne një person të tillë të tregojë të vërtetën, duke iu nënshtruar sanksioneve në rast dëshmie të rreme apo mungese bashkëpunimi.
- 23.11 Nëse ndonjë nga palët, ose dëshmitarët është thirrur sipas rregullave dhe nuk paraqitet në seancë, trupi gjykues mund të vazhdojë me seancën dëgjimore dhe të japë një vendim duke u bazuar në parashtresat dhe provat e paraqitura.
- 23.12 Pasi seanca mbyllet, palët nuk mund të paraqesin deklarata të mëtejshme me shkrim, përveç nëse urdhëron ndryshe trupi gjykues.

Neni 24 Marrja e provës tek të tretët

- 24.1 Trupi gjykues, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërojë çdo palë pjesëmarrëse në procedurë, të paraqesë në gjykim një dokument ose një send tjetër, kur çmohet e nevojshme prej saj.
- 24.2 Në këtë rast trupi gjykues jep udhëzimet e nevojshme për kohën, vendin dhe mënyrën e paraqitjes së tyre. Pala që ka kërkuar marrjen e dokumentit është e detyruar të tregojë me hollësi të gjitha rrethanat që bëjnë të besueshme se ku ndodhet dokumenti, karakteristikat e tij, si dhe faktet që do të provohen me këtë dokument.
- 24.3 Shpenzimet e nevojshme parapaguhën nga pala që ka bërë kërkesën.



- 24.4 Në rast se pala nuk i bindet urdhërimit të trupës gjykuese për të paraqitur dokumentet ose sendet, trupa gjykuese do ta vlerësojë këtë rrethanë në marrjen e vendimit sipas diskrecionit.

Neni 25 Procedura e përshpejtuar

Me pëlqimin e palëve, kryetari i DHKZM ose i trupit gjykues mund të procedojnë në një mënyrë të përshpejtuar dhe mund të nxjerrin udhëzime të përshtatshme për këtë formë procedimi.

KREU 2 Gjykimi në themel

Neni 26 Ligji i zbatueshëm për themelin

- 26.1 Trupi gjykues vendos për mosmarrëveshjen duke u mbështetur në ligjin e zbatueshëm, Rregulloret e FSHF, UEFA, FIFA, siç janë në fuqi.
- 26.2 Trupi gjykues, në mungesë të një ligj të zgjedhur nga palët, do të marrë në konsideratë të plotë legjislacionin shqiptar, veçanërisht legjislacionin e punës që është në fuqi, praktikat e mira tregtare, si dhe çdo marrëveshje kolektive që ekziston në nivel kombëtar si dhe në mënyrë të veçantë e lidhur me spe-cifikat e sportit.
- 26.3 Palët mund të autorizojnë trupin gjykues që të veprojë si ex aequo et bono.

Neni 27 Vendimi

- 27.1 Vendimi do të merret me votimin e shumicës, ose, sipas rastit, nga arbitri i vetëm.
- 27.2 Vendimi duhet të përmbajë hyrjen, pjesën arsyetuese dhe pjesën urdhëruese (diapozitivin).



27.2.1 Në hyrjen e vendimit duhet të përmenden:

- a. Përbërja e trupës së gjykimit dhe sekretari, identiteti i tyre;
- b. Koha dhe vendi i dhënies së vendimit;
- c. Palët, duke u shënuar identiteti i tyre si dhe përfaqësuesit;
- d. Objekti i kërkesës;
- e. Kërkimet përfundimtare të palëve.

27.2.2 Në pjesën arsyetuese duhet të përmenden:

- a. Rrethanat e çështjes, ashtu siç janë konstatuar gjatë gjykimit dhe përfundimet e nxjerra nga trupa gjykuese;
- b. Provat dhe arsytet në të cilat mbështetet vendimi;
- c. Baza ligjore në të cilën bazohet vendimi.

27.2.3 Në pjesën urdhëruese (diapozitivin), duhet të përmenden:

- d. Çfarë vendosi trupa gjykuese;
- e. Kujt i ngarkohen shpenzimet e gjykimit;
- f. E drejta e ankimit, afati për paraqitjen e tij dhe organi ku mund të apelohej.

27.3 Trupi gjykues mund të vendosë t'ia komunikojë palëve vetëm diapozitivin e vendimit, përpara komunikimit të vendimit të arsyetuar. Vendimi do të jetë i zbatueshëm nga momenti i njoftimit të dispozitivit me shpalljen në seancë ose komunikimin me postë elektronike.



KREU 3 E drejta e ankimit

Neni 28 Apelimi

28.1 Si mjet i fundit, vendimi i marrë nga DHKZM mund të apelohej pranë Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv, i njohur nga FSHF, CAS Lozanë, Zvicër.

28.2 Afati kohor prej 21 ditëve për apelim, do të fillojë ditën që vendimi është marrë i plotë nga ana e Dhomës.

Neni 29 Përrjashtimi nga përrgjegjësia

Me përrjashtim të rasteve kur anëtarët e DHKZM kryejnë me dashje sjellje të papërrshtatshme me detyrën e anëtarit të trupit gjykues, ata dhe sekretariati nuk do të konsiderohen personalisht përrgjegjës për veprimet e tyre, dhe gabimet në lidhje me procedurat.

Neni 30 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më datë 09.05.2024 dhe shfuqizon Rregulloren e Dhomës Kombetare të Zgjidhjes së Konfliktive të datës 01.06.2020.

Presidenti

Armand DUKA

Sekretari i Përrgjithshëm

Ilir SHULKU



ANEKSI NR. 1 TARIFAT E SHERBIMEVE DHKZM

SHËRBIMI	TARIFA
Kërkesë për Arbitrazh deri në 1.000.000 Lekë	50.000Lekë
Kërkesë për Arbitrazh nga 1.000.000 deri në 5.000.000 Lekë	100.000 Lekë
Padi Arbitrazhi me vlerë mbi5.000.000 Lekë	100.000Lekë + 1.5% të diferencës mes 5.000.000 dhe vlerës së padisë.
Kërkesë për përcaktimin/ konstatimin e statusit të lojtarit sipas Nenit 1.5 c) të kësaj Rregulloreje	50.000Lekë
Lëshimin nga sekretaria të çdo kopje vendimi apo çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit	1.000 Lekë





FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT

ADRESA: SHTËPIA E FUTBOLLIT,
RRUGA: "LIMAN KABA", NR. 5
KODI POSTAR 1019, TIRANA, ALBANIA
TELEFON: +35542 346 601
FAX: +35542 346 609
E-MAIL: INFO@FSHF.AL

WWW.FSHF.ORG